**Studenti:** Edon Mulaki

**Tema: Bindjet dhe qëndrimet e mësimdhënësve lidhur me rolin e përdorimit të teknologjisë në mësimdhënien e historisë**

**Komisioni:**

1. **Prof. Asoc. Dr. Bahtije Gërbeshi Zylfiu** – mentore
2. **Prof. Ass. Dr. Veli Kryeziu** – kryetar
3. **Prof. Ass. Dr. Florent Bunjaku** – anëtar

## ABSTRAKTI

Shekulli XXI është shekulli i zhvillimeve të mëdha teknologjike, shekulli i ndryshimeve të mëdha në sferën digjitale. Së bashku me këto ndryshime, po ndryshon edhe mësimdhënia duke u bazuar më shumë në përdorimin e teknologjisë në procesin e mësimdhënies dhe të nxënit e lëndës së historisë. Me integrimin e teknologjisë dhe shfrytëzimin e saj në procesin mësimor i jep mësimdhënies dhe mësim nxënies një mjet tejet të nevojshëm që përmirëson dhe ndihmon metodat e mësimit por edhe tërë arsimin në përgjithësi.

Në këtë studim janë hulumtuar, analizuar dhe paraqitur bindjet dhe qëndrimet e mësimdhënësve të historisë lidhur me rolin e përdorimit të teknologjisë në mësimdhënien e historisë.

Mbledhja e të dhënave është bërë përmes metodës kualitative (cilësore) me analizë tematike të të dhënave. Si instrument i këtij hulumtimi ishte intervista gjysmë e strukturuar, ku pjesëmarrës ishin gjithsej 15 mësimdhënës të lëndës së historisë, të moshave të ndryshme dhe të cilët punonin në shkolla urbane, rurale dhe mikse nëpër qytete të ndryshme të Kosovës.

Gjetjet e dhëna paraqesin një vullnet të madh të mësimdhënësve për të integruar teknologjinë në procesin mësimor ku shumica e tyre kishin bindje dhe qëndrime pozitive rreth rëndësisë dhe rolit të teknologjisë në procesin mësimor të lëndës së historisë.

Gjithashtu në këtë hulumtim si e gjetur tjetër ishte edhe rritja e angazhimit dhe motivimit të nxënësve gjatë përdorimit të teknologjisë gjatë orëve mësimore të historisë. Rezultatet e nxjerra nga ky hulumtim po ashtu tregojnë që përdorimi i teknologjisë në klasë vjen edhe me shumë sfida si: mungesa e pajisjeve teknologjike, probleme teknike dhe rrjeti i dobët, mungesa e trajnimit dhe kompetencës digjitale etj.

Diskutimi përfundimtar i gjetjeve ka siguruar një pasqyrë në perceptimet dhe përvojat e mësimdhënësve të historisë rreth ndikimit të teknologjisë në procesin e mësimdhënies së historisë por edhe sfidat dhe vështirësitë nëpër të cilat kalojnë gjatë përfshirjes së saj në procesin mësimor.

**Fjalët kyçe:** Histori, metodë, mësimdhënie, shkollë, teknologji.

**Studenti:** Edon Mulaki

**Tema: Bindjet dhe qëndrimet e mësimdhënësve lidhur me rolin e përdorimit të teknologjisë në mësimdhënien e historisë**

**Komisioni:**

1. **Prof. Asoc. Dr. Bahtije Gërbeshi Zylfiu** – mentore
2. **Prof. Ass. Dr. Veli Kryeziu** – kryetar
3. **Prof. Ass. Dr. Florent Bunjaku** – anëtar

# ABSTRACT

The 21st century is the century of great technological developments, the century of great changes in the digital sphere. Along with these changes, teaching is also changing, based more on the use of technology in the process of teaching and learning the subject of history. By integrating technology and its use in the teaching process, it gives teaching and learning a much-needed tool that improves and helps teaching methods but also the entire education in general.

In this study, the beliefs and attitudes of history teachers regarding the role of using technology in teaching history were researched, analyzed and presented.

Data collection was done through a qualitative method with thematic data analysis. The instrument of this research was a semi-structured interview, where a total of 15 history teachers of different ages and who worked in urban, rural and mixed schools in different cities of Kosovo participated.

The findings presented show a great willingness of teachers to integrate technology into the teaching process, with most of them having positive beliefs and attitudes about the importance and role of technology in the teaching process of history.

Also, another finding in this research was the increase in student engagement and motivation when using technology during history lessons. The results obtained from this research also show that the use of technology in the classroom comes with many challenges such as: lack of technological equipment, technical problems and poor network, lack of training and digital competence, etc.

The final discussion of the findings has provided an insight into the perceptions and experiences of history teachers about the impact of technology on the teaching process of history, but also the challenges and difficulties they go through during its inclusion in the teaching process.

**Keywords:** History, method, teaching, school, technology.